

LIGJ
Nr. 91/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 018, DATË 13.11.2008,
“PËR AVOKATURËN E SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Shkronja “a” e pikës 3, të nenit 4, ndryshohet si më poshtë:

“a) zyrat vendore;”

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli i nenit 11 ndryshohet dhe bëhet: “Zyrat vendore në Avokaturën e Shtetit”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit janë përgjegjëse për dhënien e asistencës juridike personave juridikë të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.”

3. Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 – 1.5 me këtë përmbajtje:

“1.1 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bën vlerësimin e organizimit të zyrave vendore pas çdo ndryshimi në organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave nga organet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

1.2 Zyrat vendore i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore pranë një ose më shumë gjykatave të shkallës së parë, me afërsi territoriale ndërmjet tyre, si dhe pranë gjykatave të apelit.

1.3 Zyrat vendore dhe kompetencat e tyre tokësore caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:

a) organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave;

b) ngarkesën e punës në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, si dhe burimet njerëzore në dispozicion.

1.4 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton Kryeministrin për nevojat e riorganizimit të zyrave vendore në bazë të vlerësimit të kryer sipas pikës 1.2 dhe pikës 1.3 të këtij neni.

1.5 Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, miraton organizimin e zyrave vendore.”.

4. Në pikën 2 hiqen fjalët “pranë gjykatave të apelit”.

Neni 3

Në pikën 2 të nenit 28 hiqet togfjalëshi “rast pas rasti”.

Neni 4

Në pikën 3 të nenit 30 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) zvarritja e pajustificuar e veprimeve të avokatit të shtetit gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, kur ka passjellë ose mund të sillte pasoja për interesat pasurore të shtetit;”.

2. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) moskryerja e detyrave funksionale të përcaktuara në këtë ligj;”.

Neni 5

Në nenin 31 të ligjit, pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1 Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme merren parasysh:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkalla e fajësisë;
- c) ekzistenca e masave të tjera disiplinore të mëparshme.”.

Neni 6

Pas nenit 32/1 shtohet neni 32/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 32/2

Pezullimi i avokatit të shtetit

1. Nëse ka prova që vërtetojnë se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga avokatit i shtetit, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, Komisioni i Disiplinës vendos pezullimin e avokatit të shtetit ose merr çdo masë tjetër të përshtatshme deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Pezullimi zgjat deri në marrjen e vendimit përfundimtar, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 (tre) muaj.

3. Avokati i Shtetit përfiton 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit.

4. Në përfundim të procesit disiplinor, në rast se nuk konstatohen shkelje disiplinore të avokatit të shtetit, ky i fundit përfiton diferencën e pagës për periudhën e pezullimit.”.

Neni 7

Në nenin 33 pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Për ankimin e paraqitur ndaj masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, zgjidhja e pasojave, për aq sa nuk parashikohet nga ky ligj, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 336, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Bega.